



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12 dhe nenit 17, shkronja b, të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 2, nënparagradi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, Udhëzimit administrativ MMPH, nr. 01/2018, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja b, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja b dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, merr këtë

## V E N D I M

### PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR ZONËN E LAGJES "KALABRIA"

#### Neni 1

##### Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

MIRATOHET Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria".

#### Neni 2

##### Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, siç është përcaktuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

#### Neni 3

##### Qëllimi i hartimit

Me hartimin e Planit rregullues të hollësishëm nga nenii 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimi i tyre me

nevojat reale dhe mundësitet për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

#### **Neni 4**

##### **Kufiri i territorit**

Zona për të cilën do të hartohet Plani rregullues i hollësishëm, gjendet në lagjen "Kalabria" dhe përfshinë sipërfaqen prej S= 355 Ha.

Parcelat ku shtrihet ky plan kanë pronësi private dhe komunale dhe i përkasin Zonës kadastrale Prishtinë.

#### **Neni 5**

##### **Subjekti përgjegjës për hartim**

Bartës i hartimit të Planit është Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 6**

##### **Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartimin e dokumentit**

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor janë të siguruara nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 7**

##### **Afati i hartimit**

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartoje në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

#### **Neni 8**

##### **Konsultimet publike**

Projektpropozimi i Planit rregullues të hollësishëm para finalizimit, duhet të vijet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Propozimplanit rregullues të hollësishëm në shqyrtim publik dhe koha për dhënen e shqyrtimeve dhe komenteve, do të shpallen përmes njoftimeve publike.

#### **Neni 9**

##### **Afati i vlefshmërisë**

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë së paku (tetë) 8-vjeçare.

**Neni 10**

**Gjuha zyrtare**

Plani rregullues i hollësishëm sipas nenit 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhë zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digitale të origjinalit.

**Neni 11**

**Programi**

Pjesë ë këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenit 11, pika 1.3 e Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor.

**Neni 12**

**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01- 350/05-257551/22, më 25.11.2022

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina



## A R S Y E T I M

i Vendimit për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Kalabria",  
në Prishtinë

### Hyrje

Duke u bazuar në nenin 17, pika 1 e Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, dhe duke u bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe kërkesat e vazhdueshme të qytetarëve për të investuar në këtë zonë, Komuna e Prishtinës do të formojë grupin punues, me përfaqësues nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Drejtortë tjera përgjegjëse, për analizë të zonës në fjalë, për inicim të proçesit të hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria" në Prishtinë, plan i cili është miratuar fillimisht me Vendim të Kuvendit të Komunës, 01. nr. 35-18196, dt. 03.08.2005.

Inicimi i tillë është bërë bazuar edhe në komunikimet paraprake me MMPH-në, përkatesisht në përgjigjen e MMPH-së, nr. 4724/18, të dt. 21.09.2018, ku thuhet se Komuna mund të hartojë plane rregulluese të hollësishme (rasti "Dodona", blloku "A-1"), pasi që Udhëzimi administrativ i MMPH-së, nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, ka hyrë në fuqi, më 14.02.2018, dhe se Komuna duhet të bazohet në dokumentin e planifikimit hapësinor, Planin zhvillimor komunal të Komunës në fuqi, dhe sipas Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor (neni 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe nënparagrafi 1.6. të Ligjit).

### Fushëveprimi

Plani rregullues i hollësishëm do të përcaktojë kushtet ndërtimore sipas Ligjit për planifikim hapësinor nr. 04/L-174, Udhëzimi administrativ MMPH, nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme dhe Udhëzimit administrativ MMPH, nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe ligjeve të tjera në fuqi. **Sipas Planit zhvillimor komunal aktual, kjo zone është e destinuar si zonë ekzistuese urbane.**

### Qëllimi

Duke u bazuar në gjendjen faktike në terren dhe trendin e zhvillimeve që kanë ndodhur që nga miratimi i Planit rregullues "Kalabria" në vitin 2005, Komuna e Prishtinës në bashkëbisedim me qytetarët e kësaj lagjeje e kanë parë të nevojshëm revidimin e Planit rregullues, me qëllim të harmonizimit të gjendjes faktike me projektet kapitale të cilat Komuna e Prishtinës i ka në proces të implementimit, siç janë: Implementimi i infrastrukturës teknike, rruga "A", përbushja e nevojave për hapësira publike dhe

sociale, po ashtu edhe projekteve tjera kapitale të cilat komuna i ka në proces për këtë lagje.

Me miratimin e planit, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës së përcaktuar. Zona ku do të hartohet plani ka shumë vite që nuk po mund të zhvillohet, për arsy se në këtë pjesë është e paraparë rruga dhe trajtimi i kolektorit dhe lidhja e saj me rrugën "Fatime Sokoli", të realizuar më parë nga Komuna, dhe parcelat private që vazhdimisht po bëhen pengesë për ndërtim të trasësë, të cilat parcela nuk po mund të shpronësohen në mungesë të mjeteve financiare.

Plani do të adresojë çështje me qëllim të orientimit të investimeve publike dhe private, rigjallërimin e zonës, zhvillimin ekonomik, çështjet mjedisore, bonuset e dendësisë dhe zhvillimet e njësive të planifikuara etj. Sipas planit planifikohet t'u jepet koeficient pronave private për ta liruar trasenë e rrugës së planifikuar dhe njëherësh për të mundësuar ndërtimin e rrugës dhe trajtin e kolektorit si nevojë e kamotshme për përmirësimin e jetës së qytetarëve të kësaj zone, dhe për të cilën rrugë janë ndaluar punimet për shkaqe pronësore.

Komuna e sheh të nevojshme dhe të arsyeshme fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", i cili plan do të inkorporohet më pas në Hartën zonale të Komunës së Prishtinës.

Ky plan do të mbulojë një periudhë së paku 8-vjeçare dhe ndryshimi i tij do të bëhet sipas ligjit në fuqi.


### **Kufiri i sipërfaqes së planifikuar**

Zona për të cilën do të hartohet revidimi i Planit rregullues të hollësishëm përfshinë sipërfaqe prej S=355 ha. Revidimi i Planit rregullues të hollësishëm do të caktojë kushtet ndërtimore sipas Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 04/L-174, UA MMPh-së nr. 08/2017, për normat teknike për planifikim hapësinor, dhe UA MMPh-së nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme.

Projektplani rregullues i hollësishëm pas finalizimit, duke u bazuar në nenin 7, pika 2, të Udhëzimit administrativ për përgjegjësitë e autoritetit të planifikimit hapësinor, si dhe Parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, nr. 05/2014 dhe sipas nenit 8, pika 4 e këtij udhëzimi, Komuna do të publikojë draftin në dispozicion të publikut, grupeve të interesit, departamenteve dhe agjencive të tjera qeveritare për shqyrtim dhe komentim, dhe kjo periudhe do të zgjatë 15 ditë.

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u bazuar në nenin 11, pika 1.6.1 e Ligjit nr. 04/L-174, do ta hartojë planin përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve njerëzore brenda Komunës.

Kufiri i propozuar për PRRH\_KALABRIA;



1. Kufiri i planit në raport me PZHK-n;



1. Kufiri i planit në raport me qytetin;

